

Eppc Kosovë kërkon një **Këshilltarë të Biznesit për shitje në terren** për klientin e saj, e cila është një kompani ndërkombetare, ndër më prestigjiozet në sektorin e digjitalizimit elektronik, e-commerce, shitje, marketing, punësim, dhe hoteleri (booking).

Një Vështrim i Përgjithshëm:

Kompania është në kërkim të një kandidati i cili duhet të ketë aftësi prezantuese profesionale dhe shitëse. Të jetë fleksibil dhe në gjendje që të krijojë dhe mbajë marrëdhënie shumë të mira të biznesit.

Përgjegjësitë Kryesore:

1. Viziton në terren bizneset dhe i edukon ata rreth shërbimeve tona
2. Prezanton produktet/shërbimet tek klientët
3. Asiston bizneset për t'i regjistruar në platformë duke plotësuar informatat e nevojshme
4. Zhvillon njohuritë rreth produkteve dhe tregut
5. Përbush nevojat e klientëve duke arritur 'targetat' mujore të shitjes
6. Monitoron tregun dhe konkurrencën duke mbledhur informata çmimet, produktet, etj
7. Zgjidh ankesat e klientëve duke hetuar problemet
8. Përgatit raportet dhe jep rekomandime për menaxhmentin
9. Kontribuon përmes punës ekipore për të realizuar rezultatet e planifikuara

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Njohuri mesatare të gjuhës angleze.
- Pëvojë e punës të paktën 3 vite në shitje.
- Fakultet të përfunduar në drejtim të informatikës, biznesit, ose marketingut
- Aftësitë kërkimore, prezantuese dhe negociuese
- Përvoja e punës në sektorin e shitjes si komercialist, banka, (kryesisht vizita në terren) është e preferuar.

Të dhënat:

Pozicioni:	Këshilltarë i Biznesit për shitje në terren;
Vendndodhja:	Prishtinë;
Orari:	40 orë;
Raporton tek:	CEO;
Udhëtime pune:	Po, brenda vendit;
Pagesa:	Shumë e mirë (fikse + bonuse);
Kontrata:	Sipas Ligjit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	28.07.2016

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

kosovo@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.